



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DPK</u>	Nr Prot Br Prot <u>03-02/1021/16</u>
Nr. i faq. Broj stranica <u>03</u>	Data Datum <u>09.03.2016</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

<b>DATË/A:</b>	08.03.2015
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK-DPK/725/16
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Vesta Nura, Koordinatore e Arteve Vizuale në Departamentin e Kulturës në Ministrin e Kulturës Rinis dhe Sporteve
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

E nderuar znj. Nura ,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me pyetjen tuaj të regjistruar me numër protokoli DPKI 03-02/725/16, ku keni then se: ( Në Konkursin publik për projekte kulturore-artistike të vitit 2016 (MKRS), ka konkuruar edhe anëtari Këshillit drejtues të njërit prej institucioneve vartëse të MKRS-ës. Andaj kërkoj nga ju një përgjigje lidhur me konkurrimin e këtij anëtari dhe se, përkrahja e projektit të tij nga MKRS-ja a bie ndesh me ligjin.

Agjencia kundër Korrupsionit duke u bazuar ne mandatin qe ka ofron këtë:

## OPINION

Përfitimi nga konkursi publik për projekte kulturore-artistike të vitit 2016 që ndan Ministria e Kulturës Rinis dhe Sporteve, nga një zyrtar i lartë i MKRS-së mund të cilësohet si situatë me konflikt të Interesit .

## Arsyetim

Në kuadër të ushtrimit të kompetencave ligjore, përkatësisht sipas nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia është autoritet qendror i cili ndër të tjera bën mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara ligjore.

Në nenin 6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është paraparë nocioni i konfliktit të interesit i cili përcakton se “konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”, ndërsa neni 4 i këtij ligji ka përcaktuar kategorinë e zyrtarëve të lartë publik, të cilët i nënshtrohen këtij ligji. Rrjedhimisht në këtë nen janë paraparë të gjithë ushtruesit e funksioneve publike të emëruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Kryeministri si dhe Ministrat, e që nuk përmenden shprehimisht me këtë ligj.

Pyetja juaj drejtuar AKK-së se a është kundërshtim me ligjin në fuqi përkrahja e projektit të zyrtarit të lartë të MKRS-së i cili ka konkuruarë në Konkursin publik për projekte kulturore-artistike të vitit 2016, mund të themi se zyrtari i lartë i MKRS-së nuk do duhej të përfitoj fonde për projektet e parapara kulturore-artistike për vitin 2016.

Kjo për faktin se këto fonde janë të destinuara për artistë që nuk janë të punësuar apo të angazhuar në çfarëdo mënyre nga Ministria e Kulturës apo institucionet kulturore në kuadër të Ministrisë. Andaj, ashtu siç është sqaruar në opinionin e lëshuar më herët nga Agjencia (datë 10.07.2013, AKK-DPK – 4418/12).

Përfitimi i fondeve apo përkrahja në çfarë do mënyre i zyrtarit të lartë në institucionit tuaj do të ndikonte në humbjen besimit të publikut dhe konkurrueseve tjerë në institucionin tuaj .

Rregullorja Për Subvencionimin Në Fushën e Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Rinisë dhe Sportit nr.09./2015 paraqitjen e Konfliktit të Interesit e ka parapara qe zgjidhja e Situatave të Konfliktit të Interesit të behet sipas Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Ne kuadër te Këtij ligji ne nenin 7 janë paraparë Parimet e veprimit dhe mos veprimit të zyrtarit gjatë ushtrimit te funksionit publik :

1. Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të veproj në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejtë që interesin e tij privat ta vërë para interesit publik, për mbrojtjen e të cilit është zgjedhur apo emëruar.